

IT Panakeia shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 22

“IT Panakeia” shpk
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	5,124,554	3,964,513
Llogari te arketueshme tregetare	5	8,320,954	3,773,449
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	6	676,729	9,639,302
Te tjera llogari te arketueshme	7	5,614,990	4,661,336
Inventari	8	3,353,752	3,295,685
Shpenzime te shtyra	9	-	103,200
Totali i aktiveve afatshkurtra		23,090,979	25,437,485
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	1,194,866	1,390,220
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,194,866	1,390,220
Totali i aktiveve		24,285,845	26,827,705
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregetare	11	4,360,443	935,483
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	12	28,305,742	24,935,576
Detyrime tatimore	13	218,680	933,674
Te tjera detyrime	14	1,512,085	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		34,396,950	26,804,733
Detyrime afatgjata			
Llogari te pagueshme nga palet e lidhura	15	3,958,400	-
Totali i detyrimeve afatgjata		3,958,400	-
Totali i detyrimeve		38,355,350	26,804,733
Kapitali			
Kapitali i nenshkruar		2,400,000	400,000
Rezerva ligjore		240,000	40,000
Fitime/humbje të mbartura		(417,028)	-
Fitime/humbje nga bashkimi me ikub.al		(12,875,853)	-
Fitimi i ushtrimit		(3,416,624)	(417,028)
Totali i kapitalit		(14,069,505)	22,972
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		24,285,845	26,827,705

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"IT Panakeia" shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	14,373,631	19,401,344
Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	(203,140)	(24,274)
Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme		(10,590,985)	(11,790,471)
1) Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme	19	(7,246,626)	(8,980,053)
2) Te tjera shpenzime	20	(3,344,359)	(2,810,418)
Shpenzime të personelit	21	(6,477,027)	(7,570,225)
1) Paga dhe shpërblime		(5,549,015)	(6,517,780)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(928,012)	(1,052,445)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(459,999)	(403,620)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	22	(29,627)	(129)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare		(29,477)	290
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	23	(29,477)	290
Fitimi para tatimit		(3,416,624)	(387,085)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	-	(29,943)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	(29,943)
Fitimi i vitit		(3,416,624)	(417,028)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(3,416,624)	(417,028)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"IT Panakeia" shpk
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Humbje te mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	400,000	40,000	-	-	753,220	1,193,220
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019						
Fitimi / Humbja e vitit					(417,028)	(417,028)
Lëvizjet përmes kapitalit			753,220		(753,220)	-
Dividendë të paguar			(753,220)			(753,220)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	400,000	40,000	-	-	(417,028)	22,972
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2020						
Fitimi / Humbja e vitit					(3,416,624)	(3,416,624)
Lëvizjet përmes kapitalit				(417,028)	417,028	-
Bashkim me Perthithje lkub.al shpk	2,000,000	200,000		(12,875,853)		(10,675,853)
Dividendë të paguar						-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	2,400,000	240,000	-	(13,292,881)	(3,416,624)	(14,069,505)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori IT Panakeia shpk më 29.03.2021 dhe janë firmosur si më poshtë:



Alger BREGU
 Administrator

"IT Panakeia" shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(3,416,624)	(417,028)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(10,480,641)	33,299
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	(29,943)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	459,999	403,620
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	3,564,614	(1,170,561)
Rënie/(rritje) në inventarë	(58,067)	(245,553)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	11,106,353	516,929
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	444,264	(34,998)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	1,619,898	(944,235)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(264,645)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(264,645)	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Dividendë të paguar	-	(753,220)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	(753,220)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	1,355,253	(1,697,455)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	3,964,513	5,695,267
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(195,212)	(33,299)
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 5,124,554	3,964,513

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "IT Panakeia" Shpk është regjistruar si shoqëri me përgjegjesi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendres Kombëtare të Regjistrimeve me datë 20/03/2007. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nentor 1992 "Per Shoqërite Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 2,400,000 leke i zotëruar 100% nga ortaku i vetëm i shoqërisë Investment SHERKO - ikub GROUP shpk.

Bazuar në "Marreveshjen për Bashkimin me Perthithje të Shoqërive" ndërmjet shoqërisë IT Panakeia shpk me NIPT K71702025M, dhe shoqërisë ikub.al shpk me NIPT K62217018V, të datës 04.12.2020, Shoqëria IT Panakeia shpk ka perthithur shoqërinë ikub.al shpk.

Duke filluar nga data 11.12.2020, Shoqëria ikub.al shpk është reregjistruar pa Likuidim pranë Qendres Kombëtare të Biznesit dhe si e tillë nuk ka me personalitet juridik.

Në bazë të Nenit 215, pika 1 e Ligjit Tregtar, Shoqëria e Perthithur "ikub.al" sh.p.k, i ka transferuar Shoqërisë Perthithëse "IT PANAKEIA" sh.p.k., kundrejt aksioneve të kësaj të fundit, të gjitha aktivitetet dhe pasivët sipas Bilancit të Dates së Fundit Kontabel si dhe të gjitha llojet e tjera të drejtave dhe detyrimeve, duke marrë në konsideratë edhe cdo ndryshim të ndodhur deri në datën e mbylljes së bashkimit me perthithje.

Me transferimin e aktiveve dhe të drejtave e detyrimeve, "IT PANAKEIA" sh.p.k, ka marrë në posedim të gjithë evidencat, librat, korrespondencat, regjistrimet, Marreveshjet dhe dokumenta të tjera për të provuar ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve që janë transferuar nga shoqëria "ikub.al" sh.p.k.

Me transferimin e të gjitha të drejtave, aktiveve dhe detyrimeve Shoqëria "IT PANAKEIA" sh.p.k, do të gëzojë të drejtat për të ngritur pretendime ligjore ndaj këtyre aktiveve si dhe do të mbartë detyrimin për t'u përgjigjur ndaj pretendimeve që mund të ngrenë për të treta për detyrime të shoqërisë së perthithur.

Administrator i shoqërisë është Z. Algert Bregu.

Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën Abdyl Frashëri, EGT Tower, Pll. 11/1, Kati 4, Tiranë. Ajo është e regjistruar në Degen e Tatimeve, Tiranë me NIPT K71702025M.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është "Konceptimi, zhvillimi, implementimi, testimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Import-eksport të mallrave, materialeve, shërbimeve etj. Tregtim elektronik dhe fizik i mallrave, materialeve, shërbimeve, të çfaredollos natyrë ato qofshin, të lejuara nga ligji. Aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qira etj".

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 12 punonjës (2019: 12 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar

njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivitet financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitet. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe

vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t’u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	5,103,758	3,557,939
Llogari rrjedhëse	5,103,758	3,557,939
Mjete monetare në arkë	20,796	406,574
	<u>5,124,554</u>	<u>3,964,513</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregëtare

Llogaritë e arkëtueshme tregëtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	8,320,954	3,773,449
	<u>8,320,954</u>	<u>3,773,449</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
ikub.al	-	1,149,436
ikubINFO shpk	578,529	7,108,516
	<u>578,529</u>	<u>8,257,952</u>

“IT Panakeia” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Investment Sherko	98,200	83,000
ikub.al	-	1,298,350
	<u>98,200</u>	<u>1,381,350</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim fitimi	2,026,197	966,034
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	3,588,793	3,695,302
	<u>5,614,990</u>	<u>4,661,336</u>

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mallra	3,353,752	3,295,685
	<u>3,353,752</u>	<u>3,295,685</u>

“IT Panakeia” shpk
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje e pajisje zyre	Pajisje informatike	Te tjera	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2018	423,331	5,207,177	3,569,561	9,200,069
Shtesa				-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	423,331	5,207,177	3,569,561	9,200,069
Shtesa	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	423,331	5,207,177	3,569,561	9,200,069
Shtesa nga perthithja e ikub.al	-	1,131,949	-	1,131,949
Gjendja më 31 dhjetor 2020	423,331	6,339,126	3,569,561	10,332,018
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2018	(213,552)	(4,011,147)	(2,658,318)	(6,883,017)
Amortizimi i vitit	(41,956)	(299,007)	(182,249)	(523,212)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	(255,508)	(4,310,154)	(2,840,567)	(7,406,229)
Amortizimi i vitit	(33,565)	(224,256)	(145,799)	(403,620)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(289,073)	(4,534,410)	(2,986,366)	(7,809,849)
Amortizimi i vitit	(47,585)	(292,420)	(119,994)	(459,999)
Amortizimi nga perthithja e ikub.al	-	(867,304)	-	(867,304)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(336,658)	(5,694,134)	(3,106,360)	(9,137,152)
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	167,823	897,023	728,994	1,793,840
Gjendja më 31 dhjetor 2019	134,258	672,767	583,195	1,390,220
Gjendja më 31 dhjetor 2020	86,673	644,992	463,201	1,194,866

“IT Panakeia” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

10. Shpenzime te periudhave te ardheshme

Gjendjet e shpenzimeve te periudhave te ardheshme me 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 jane si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	-	103,200
	<u>-</u>	<u>103,200</u>

11. Llogari të pagueshme tregëtare

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitorë	4,230,627	873,831
Furnitorë për fatura të pambërritura	129,816	61,652
	<u>4,360,443</u>	<u>935,483</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme tregtare		
Investment Sherko	1,015,330	-
ikub.al	-	1,981,443
Romeo Sherko	884,000	-
Financim Investment Sherko	10,820,800	-
Dividendë të pagueshëm		
Div.Investment SHERKO-ikub Group	15,585,612	22,954,133
	<u>28,305,742</u>	<u>24,935,576</u>

“IT Panakeia” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	135,426	140,435
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	21,760	46,797
Tatim në Burim	20,296	-
TVSH për t'u paguar	41,198	746,442
	<u>218,680</u>	<u>933,674</u>

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime ndaj personelit	444,264	-
Detyrime të tjera	1,067,821	-
	<u>1,512,085</u>	<u>-</u>

15. Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Hua afatgjata nga Investment Sherko	3,958,400	-
	<u>3,958,400</u>	<u>-</u>

16. Kapitali aksionar

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 2,400,000 leke i zotuar 100% nga ortaku i vetem i shoqërisë Investment SHERKO - ikub GROUP shpk.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kapitali Investment Sherko – ikub GROUP	2,400,000	400,000
	<u>2,400,000</u>	<u>400,000</u>

Bazuar në “Marreveshjen për Bashkimin me Perthithje të Shoqërive” ndërmjet shoqërisë IT Panakeia shpk me NIPT K71702025M, dhe shoqërisë ikub.al shpk me NIPT K62217018V, të datës 04.12.2020, Shoqëria IT Panakeia shpk ka perthithur shoqërinë ikub.al shpk.

“IT Panakeia” shpk

Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

Kuotat e kapitalit të shoqërisë ikub.al, me vlerë 2,000,000 leke, të cilat zotërohen 100% nga ortakët i vetëm “Investment Sherko – ikub GROUP”, janë transferuar me vlerë nominale tek shoqëria përthithëse IT Panakeia shpk e cila zotërohet nga ortakët i vetëm shoqëria “Investment Sherko – ikub GROUP”.

Kapitali i shoqërisë IT Panakeia shpk, rritet me 2,000,000 leke, dhe ortakët i vetëm me 100% të kuotave mbetet shoqëria “Investment Sherko – ikub GROUP”.

Ortakët e dy Shoqërive para bashkimit me përthithje:

Kapitali IT PANAKEIA:

Ortakët: Investment SHERKO – ikub GROUP

Vlera e kapitalit: 400,000 leke

Numri i pjesëve: 100

Pjesëmarrja në përqindje: 100%

Kapitali ikub.al:

Ortakët: Investment SHERKO – ikub GROUP

Vlera e kapitalit: 2,000,000 leke

Numri i pjesëve: 100

Pjesëmarrja në përqindje: 100%

Totali i kapitalit të shoqërisë IT Panakeia pas bashkimit me përthithje:

Ortakët: Investment SHERKO – ikub GROUP

Vlera e kapitalit: 2,400,000 leke

Numri i pjesëve: 100

Pjesëmarrja në përqindje: 100%

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>
Sherbime programimi e zhvillimi	3,814,175	6,816,383
Te ardhura nga komisione ndërmjetesimi	591,523	715,287
Shitje mallra	8,990,528	11,329,674
Te ardhura nga reklamata	911,708	-
Te ardhura nga mirembajtje web, hosting	65,697	-
Te ardhura nga sherbime të tjera	-	540,000
	<u>14,373,631</u>	<u>19,401,344</u>

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera financiare, që detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Fitime nga këmbimet valutore	119,595	23,511
Humbje nga këmbimet valutore	(322,735)	(47,785)
	<u>(203,140)</u>	<u>(24,274)</u>

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më Dhjetor 31, 2020</u>
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	14,373,631
Shitje te dekalruar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH	<u>14,373,631</u>
Shitje mallrash	8,990,528
Sherbime	4,405,698
Te ardhura nga reklama	911,708
Të ardhura të tjera	65,697
Te ardhura te deklaruar ne PASH te cilat jane deklaruar shitje ne FDP	<u>14,373,631</u>
Te ardhurat nga interesat	215
Fitim nga kembimet valutore	119,595
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit	<u>14,493,441</u>

19. Lëndet e para dhe shërbimet

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe atë të mbyllur më 31 Dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Sherbime zhvillimi	828,912	1,084,920
Kosto e mallrave te shitur	5,642,717	7,122,113
Sherbim reklamimi	769,997	773,020
Rinovim domain	5,000	-
	<u>7,246,626</u>	<u>8,980,053</u>

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Qira Zyra	195,000	-
Shpenzime energji, uje	24,944	-
Qera serveri	71,581	-
Sherbime konsulence	219,990	221,567
Shërbime telefonike+internet+postare	1,559,578	1,742,823
Komisione bankare	217,161	122,544
Taksa vendore	74,801	67,000
Blerje kancelari dhe te ngjashme	30,043	48,357
Shpenzime mirembajtje pajisje dhe zyre	16,167	5,667
Shpenzime te ndryshme	935,094	602,460
	<u>3,344,359</u>	<u>2,810,418</u>

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	5,549,015	6,517,780
Shpenzime për sigurime shoq e shend	928,012	1,052,445
	<u>6,477,027</u>	<u>7,570,225</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 12 (2019:12).

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Gjoba dhe penalitete	29,627	129
	<u>29,627</u>	<u>129</u>

23. Shpenzime financiare Neto

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga interesat	215	290
Shpenzime Financiare	(29,692)	-
	<u>(29,477)</u>	<u>290</u>

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2019;15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
	<u>Totali</u>	<u>Totali</u>
Fitimi para tatimit	(3,416,624)	(387,085)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	943,062	586,702
Penalitet, gjoja e dëmshpërblime	29,627	129
Shpenzime të tjera pa dokumenta	913,435	586,573
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(2,473,562)	199,617
Humbje fiskale e mbartur		
Fitimi i tatueshem/ humbje fiskale	(2,473,562)	199,617
Shkalla tatimore e tatim fitimit	15%	15%
Tatim fitimi @15%	0	29,943
Fitimi/humbja e Vitit	(3,416,624)	(417,028)
Tatim mbi fitimin		
Tatimi I parapaguar më 01.01.2020/2019	966,034	995,977
Tatim fitim I viteve te kaluara mbartur nga ikub.al	1,060,163	
Tatimi i vitit ushtrimor	-	29,943
Tatimi i derdhur tepër/(për tu paguar)	<u>2,026,197</u>	<u>966,034</u>

“IT Panakeia” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

25. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
<i>Te pagueshme tregtare</i>		
Investment Sherko	1,015,330	-
ikub.al	-	1,981,443
Romeo Sherko	884,000	-
Hua afatgjata nga Investment Sherko	3,958,400	-
Financim Investment Sherko	10,820,800	-
<i>Dividende te pagueshem</i>		
Div.Investment SHERKO-ikub Group	15,585,612	22,954,133
	<u>32,264,142</u>	<u>24,935,576</u>
	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arketueshme nga palët e lidhura		
<i>Të arketueshme tregtare</i>		
ikub.al	-	1,149,436
ikubINFO shpk	578,529	7,108,516
<i>Të arketueshme te tjera</i>		
Investment Sherko	98,200	83,000
ikub.al	-	1,298,350
	<u>676,729</u>	<u>9,639,302</u>
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shitje ndaj palëve e lidhura		
ikubINFO	3,222,651	4,470,863
ikub.al	-	40,250
	<u>3,222,651</u>	<u>4,511,113</u>
Blerje nga palët e lidhura		
Investment Sherko - ikub Group	29,688	-
Romeo Sherko	195,000	-
	<u>224,688</u>	<u>-</u>

26. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje

(Vlerat janë në Lek)

gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqerise nuk jane audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020. Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare. Detyrime te mundshme qe mund te rezultojne nga nje auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

27. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.